

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Demokracia jonë pa hardware dhe software?!
ADRESA	https://www.gazetatema.net/blogu-tema/demokracia-jone-pa-hardware-dhe-software-i585714
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 06:27:33 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 06:23:44 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a25c50f0c9ed7ec79521581dff1bcbb1abf8a450cacae1a099d0fd72efaaa072
TEKSTI	2e75f8c2b267649b6203133c279274056cb040b1a75de47f6b53b70c764ae134
PAMJA	c3fede66905ead6738ca28f7db757408af055a087f81d3c39b1bb212a9624201

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d821d6bf7bc261ab5df70c75999bad33060fd804950865f498ad6243d924b395
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	5e97407bb1567bb3877f809f8217470d0d3544ef3905c908120b91ac492e3b20
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d821d6bf7bc261ab5df70c75999bad33060fd804950865f498ad6243d924b395>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

Demokracia jone pa hardware dhe software? Dajja e trenit nga shinat ne Normandi, dyshohet per sabotazh i Trump akuzon Iranin per sulmin ndaj tubacionit te natës në fundit

Demokracia jonë pa hardware dhe software?!



13 Shtator 2026, 08:23 Blog Nga Ben Andoni

Leksiku, përcaktimet dhe dallimet që derdhen sot për demokracinë nuk kanë fund. E përdor protestuesi i zakonshëm i Flamingove, e përdor administrata e Ramës, e përdorin rëndom politikanët, e përdor vetë kryeministri dhe z.Berisha dhe gjithë shpura e tyre. Por kur mendon se për demokracinë flitej rëndom edhe në socializëm, atëherë njeriu ndalet pakëz. Fjalën *Demokraci* e përdorte dikur shpesh edhe vetë lideri komunist Enver Hoxha.

Gjithsesi, në periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore (L2B), kur po frynte një fillad paqësie pas katrahurës së përbotshme, falë edhe shkollave të ndryshme të studimeve politike, perceptimet dhe interpretimet për demokracinë si rend qeverisës u shtuan shumë. Sot, ka kaq inflacion për këtë fjalë, sa që demokraci etiketojnë veten dhe shumë rende shtetërore që nuk lidhen me të. Në rastin e vendit tonë, tashmë “Protesta e Flamingove” e ka sjellë si alternativë brenda sloganit të “Shqipërisë së Re”, ku njerëzit besojnë se mjafton largimi i Ramës që ka qeverisur në katër mandate (tashmë gati duke e personalizuar shtetin me pushtetin e tij), si edhe vendosja e tij dhe Berishës në burg dhe, gjërat të ndryshojnë. Shqipëria mund të bëhet vërtetë demokratike!! *“E duam Shqipërinë, si gjithë Evropën”*, ishte slogan i viteve ’90, por që u harrua fillimisht nga ata që e shqiptonin më shumë. Naiviteti i sotëm i ngjason më shumë atyre të viteve të para së pas L2B ose asaj të muajve të para në kapërcyellin e Socializmit drejt Ekonomisë Liberale. Ishte koha që të gjithë besonin. Kishte ligje, kishte shtete me ndarje pushtetesh dhe kishte administrata që mbartnin objektiva.

Megjithatë shpjegimet më të mira për demokracinë, po vinë me realitetet tona. Dhe, është vërtetë interesant mënyra sesi politologët e kanë futur në hulli të kibernetikës edhe konceptin e demokracisë në vetvete. Në veprën e tyre themelore të vitit 1998 në fushën e shkencave politike, respektivisht trioja e njohur e politologëve (Richard Rose, William Mishler dhe Christian Haerpfer) të interesuar shumë për demokracinë në vendet ish komuniste, formuluan një leksik dhe një kuadër që t’i përshtatej kohës. Kjo nënkuptonte se institucionet dhe procedurat politike përbëjnë “hardware-in” (bash pjesën fizike/teknike) e një sistemi demokratik, kurse opinioni publik, kultura qytetare dhe sundimi i ligjit shërbejnë “software” (programi/sistemi operativ), atë që e mban dhe e zhvillon punën. Kur një vend miraton ligje demokratike (“software”), por i mungon infrastruktura shtetërore e qëndrueshme ose gjykatat për t’i mbështetur ato (“hardware”), sistemi pëson defekte derisa jep pasoja. Në librin e tyre të rëndësishëm të vitit 1998, *“Demokracia dhe Alternativat e saj: Të kuptosh Shoqëritë Post-Komuniste”* (*“Democracy and Its Alternatives: Understanding Post-Communist Societies”*), ata e shpjeguan me fakte idenë e tyre por edhe më shumë se kaq, thjeshtuan atë pjesë kaotike që na vret në Shqipëri për ditë, mungesën e institucioneve dhe përgatitjen e njerëzve.

Shqipëria është e mbushur me ligje të mira, por që janë gati të porealizueshme prej një administrate të paaftë dhe aspak empatike. Pasojat janë ato që lidhen me pronat dhe sidomos vetë sistemin e pareformuar të Drejtësisë, i cili e ka çuar tashmë stokun e dosjeve vetëm te Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm në shifrën alarmante prej rreth 48,000 deri në 50,000 dosje në pritje. Koha mesatare e pritjes për një çështje civile në këtë gjykatë kalon të 7 vitet, referohet në një analizë të Institutit për Studime Publike dhe Ligjore.

Në argumentin tonë, Shqipëria ka këtë korrupsion dhe problem politik sepse besimi te *institucionet, drejtësia dhe pronësia* nuk kanë qenë kurrë njëkohësisht në formën e tyre moderne. *“Të kapim kohën e humbur”*, shkroi në fund të komunizmit, mjeku Ylli Popa që do bëhej kryetar i Akademisë së Shkencave, po ne kurrë nuk e kapim. Më keq akoma, kur ra komunizmi, ne shkatërruam edhe atë version të dobët që kishim të kësaj triade. Gjatë gjithë historisë, shqiptarët i kanë përjetuar institucionet të lidhur veç me fuqinë e politikës. Periudha osmane e kishte të lidhur besimin vetëm me kreun e njësisë turke (Pasha, spahi etj.), që ishte në lokalitet; në kohën e Zogut gjithçka ishte e lidhur me shpurën e mbretit dhe klanet afër tij. Enver Hoxha e çoi në zgrip, pasi e ngriti institucioni politik të PPSH mbi shtetin. Kjo bënte që shqiptarët e pas viteve ’90 me shtet të fortë identifikonin, vetëm pushtetin e Berishës (që po e tregon edhe në ditët e fundit), të cilit i drejtoheshin për çdo gjë; Ramës sot (me pushtetin e tij të pamatë dhe gati identifikimin e tij me shtetin); me Nanon që drejtoi pak por që edhe brenda liberalizimit të tij i shikoje këto elementë në një formë apo tjetër. Ndërkohë që administrata, të paktën ajo që lidhet direkt me njerëzit, duhej të ishte e ftohtë, profesionale dhe neutrale ajo iu nënshtrua pushtetit dhe interesave të ngushta sesa shërbimit të publikut. E tillë është edhe sot, ndaj Rama nuk mund ta anashkalonte.

Sa i përket Drejtësisë, komunizmi këtu e shkatërroi me Luftën e pamëshirë të Klasave, kurse Drejtësia që suprimoi dhe avokaturën kishte si busull veç Kodeve Juridike dhe “mbështetjen nga Mësimet e Partisë”, gjë të cilën e manifestonte deri në sloganet brenda sallës gjyqësore. Dhe, s’mbaron këtu. Pas ’90: Nuk bëmë Lustrimin e duhur dhe disa deputetë të legjislaturave kanë raportuar për kolegë të tyre spiunë, ndërkohë që partitë ende sot nuk i verifikojnë kandidatët e tyre. Kurse sa për pronat, ato janë të shoqëruara me paradokset pafund, ku një palë thotë *“kthim te pronari i vjetër”* dhe pastaj pala tjetër nxjerr *“listat e legalizimeve”* (për ata që kanë ndërtuar pa leje). Pretendohet se, një e treta e çështjeve në Gjykatën e Strasburgut kundër Shqipërisë kanë të bëjnë me pronën! Më shumë se për çdo vend tjetër në Evropë. Dhe kur nuk mund të garantosh pronën, nuk mund të garantosh as institucionin, pasi detyra e parë e institucionit

është garantimi dhe shenjtëria e pronës. Dhe, kur prona rëndom nuk merret ose s’është e sigurt, ke nevojë për të fortin, mikun dhe sidomos partinë.

Ndaj, Shqiptari i Flamingove dhe ai tjetër që po rri në kafe këto kohë e pret një rendje e gjatë, ku rregullimi i këtyre çështjeve dhe korrupsioni do duan dekada të riparohen. Kuptohet, nëse shqiptari i shekullit XXI do zgjohej do e kuptonte sesa e vështirë është dhe sesa punë do duhet për një Shqipëri moderne. Të paktën, u kemi borxh të vërtetën shqiptarëve se jetojmë në një vend aspak normal. Software dhe hardware shqiptar në këto 35 vite na e tregojnë se kemi një rrugë të gjatë, pasi akoma s’ka servis për këtë shqetësim. Përtej maratonës të sfilitjes së përditshme, përmuajshme, vjetore..., na duhet ende udhë sepse Demokracia jonë është dhe me gjasa do mbetet pa hardware dhe software (Homo Albanicus)

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Banalizimi i protestës dhe elita e vjetër politike

18:43 Blog

Besnik Dizdari, si dëshmi e kohës kur gazetaria ishte një profesion

18:30 Blog / 6 komente

Pazarokracia

17:16 Blog / 4 komete

Unë jam me Petrit Malajn

14:45 Blog / 51 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.